



Viti i XIII -te i Botimit, Nr.1,
Qershor 2021

ROLI I KURRIKULËS DHE I SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN GJUHËSOR TË FËMIJËVE

Albana Tahiri*, Esmeralda Strori*

*Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Albanian University

Adresë kontakti: *albanatahiri@gmail.com*

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë një panoramë e cila lidhet me përmbajtjen dhe strukturën e programit mësimor të mësimin në gjuhën amtare, e cila është shumë e rëndësishëm për formimin intelektual të çdo individi.

Gjuha amtare është instrument krijues i shprehive vetjake, instrument i zhvillimit emocional, shërben për krijimin e ideve origjinale dhe zhvillimin e personalitetit. Gjuha është faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin e kombeve. Ajo ndërton kombet dhe mban kombet së bashku.

Kurrikulat e gjuhës amtare duhet të jenë vazhdimisht në koherencë me programet e kësaj lënde, me vendet europiane dhe me ndryshimet që bëhen në këto programe.

Të mësuarit me kompetenca është një trend i kohës, zbatimi i të cilave, kërkon strategji të gjetura dhe të suksesshme të nxëni. Arritja e kompetencave sipas fushave të të nxënit duhet të shoqërohen me instrumente të sakta vlerësimi dhe kontrolli.

Zhvillimi i mendimit kritik duhet të jetë një proces i vazhdueshëm didaktik në të gjitha veprimtaritë e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit të nxënësve.

Vendoset theksi se si praktikatat e sotme të mësimdhënies efektive, gjithnjë e më tepër po transformohen dhe pasurohen me elementë të rinj, duke i ardhur në ndihmë procesit të mësimdhënies. Pikërisht, auditorët e universiteteve kanë për detyrë të formojnë mësues që janë në gjendje të zbatojnë një kurrikulë të re, që bazohet në kompetenca, dhe zbatojnë risi didaktike në mësimdhënie, ku nxënësi është në qendër të saj dhe mësimdhënia merr karakter gjithëpërfshirës.

Fjalët çelës: *komponencë gjuhësore, kurrikulë, zhvillim gjuhësor, arsim, didaktikë etj.*

THE ROLE OF CURRICULUM AND SCHOOL IN CHILDREN'S LANGUAGE DEVELOPMENT

Abstract

The aim of this paper is to present a panorama which has to do with problems related to the content and structure of the curriculum.

Learning the mother tongue is very important for the intellectual formation of each individual.

Creates facilities for learning and acquiring knowledge. Is an instrument of emotional development, an instrument of student growth, serves to create original ideas and develop personality. Language is a very important factor in the development of nations. It builds nations and holds them together.

Mother tongue curricula must be constantly in coherence with the curricula of this subject, with European countries and with the changes that are made in these programs.

Achieving competencies according to learning areas must be accompanied by accurate assessment and control instruments.

The development of critical thinking should be an ongoing didactic process in all student speaking, reading and writing activities.

Emphasis is placed on how today's effective teaching and learning practices are transformed and enriched with new elements, helping the teaching and learning process.

A special attention should be shown to increase students' progress in gaining linguistic, grammatical and spelling knowledge and skills in written works for a better intellectual development at all their levels of knowledge, because language is the product of all their formation.

Precisely, university auditors have the task of training teachers who are able to implement a new curriculum, based on competencies, to implement new didactic innovations in teaching, where the student is at its center and teaching takes on a comprehensive character.

Key words: *curriculum, education, language component, language development*

Albana Tahiri, Esmeralda Strori

Hyrje

Në njëzet vitet e fundit në lidhje me mësimin e gjuhës shqipe janë zbatuar reforma, të cilat i kanë dhënë asaj pamjen e një kurrikule bashkëkohore të krahasueshme me modelet më të arrira evropiane dhe më gjerë.

Që nga viti 2000 dhe këtej kurrikula e gjuhës shqipe është transformuar në të gjitha komponentët e saj përmbajtësore dhe metodologjike. Sot mund të themi se kjo kurrikul është bërë e krahasueshme me shumë përvoja të tjera bashkëkohore evropiane dhe rajonale. Nisur që nga ndryshimet me karakter ideologjik strukturor përmbajtësor. Sot kurrikula e mësimin të gjuhës shqipe si dhe shumë kurrikula të tjera udhëhiqet nga parime të njëjta shkencore, metodologjike. Në këtë kurrikul janë të pasqyruar mirë, fushat e studimit, linjat, nënlinjat duke nisur nga të parit, të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe njohuritë nga fusha e studimit të metagjuhës, gramatika, drejtshkrimi, pikësimi etj.

Në vitin 2013-2014 Plani Mësimor i Arsimit Bazë, Tiranë, vë në dukje se kurrikula e mësimin të gjuhës shqipe ka pasqyruar edhe parimet më të reja të cilat lidhen me të mësuarit e gjuhës bazuar në kompetenca ⁽¹⁾. Përcaktohen qartë njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore për çdo kompetencë.

Siç dihet, lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike dhe për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit: fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes; fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit (Kurrikula e gjuhës shqipe, Tiranë, 2020).

Gjuha amtare është mjeti për të shprehur ndjenjat, idetë, besimet, vlerat, dijet, dhe që siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur eksperiencat e tyre dhe për të thyer barrierat që ndajnë individët. Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë mundëson zhvillimin e kompetencave gjuhësore, në mënyrë që të bëhen qytetarë aktive dhe me aftësi të mjaftueshme për rritjen intelektuale përmes gjuhës.

ROLI I KURRIKULËS DHE I SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN GJUHËSOR TË FËMIJËVE

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare, si të domosdoshme për një individ i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale (MAS). Këtë mision lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj të dëgjuarit dhe të lexuarit e teksteve të gjuhës së folur, së shkruar dhe mediatike; të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale dhe përdorimit të drejtë të gjuhës.

Pranimi i gjerë i qasjes komunikative të mësimdhënies së gjuhës ka rezultuar në interpretime dhe aplikime relativisht të ndryshme. Fokusi zhvendoset nga dhënia e dijes te zbatimi praktik i koncepteve të kësaj qasjeje, duke përshpejtuar procesin e të nxënësve. Në një kumtesë shkencore profesionale Shegani (Satka) shprehet se ‘’, kompetenca gjuhësore e një folësi duhet parë si një shumë e kompetencave të tij rreth normave të ndryshme, të cilat karakterizohen nga opsione të rregullave të ndryshme. Dmth kompetenca gjuhësore bën pjesë në një kompetencë më të gjerë e globale komunikative. ‘’(1)

“Kompetenca nuk mund të parashikohet dhe nuk mund të përcaktohet “a priori”; ajo varet nga nxënësi ose grupi i nxënësve, nga njohuritë dhe përvoja e tyre, nga kuptimi i situatës, nga ajo që mendohet se mund të bëhet në këtë situatë, nga burimet që zotërohen në këtë situatë etj.” (IZHA 2014, duke e trajtuar dhe nga këndvështrimi i kurrikulës

‘’Kurrikula mbi bazë kompetencash është kurrikul që ka si qëllim të zhvillojë kompetencat dhe është e strukturuar mbi bazën e tyre. Ndërsa kompetenca në vetvete është kombinimi i dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve të përshtatshme për një kontekst të caktuar të një situate të njohur ose të re, kompetencat kyçe janë ato për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësimin dhe zhvillimin personal, për qytetari aktive, përfshirjen sociale dhe punësimin. ‘’ (IZHA 2019)

Pa dyshim të gjithë komponentët që trajtohen në kurrikulën me bazë kompetencash bën të mundur realizimin e procesit të të nxënësve, i cili duhet parë si proces i vazhdueshëm ,ku nuk është thjesht të sigurohemi që nxënësit të marrin “mësim”, por të sigurohemi që ata të zhvillohen e të mësojnë, duke nxitur që të angazhohen në reflektimin kritik bashkëpunues dhe të zhvillojnë një kulturë besimi dhe ndarje me të tjerët. Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës nis që në arsimin bazë. Kompetenca zhvillohet vazhdimisht dhe nuk ka pikëmbërritje. Kompetenca zhvillohet gjatë gjithë jetës. Njohja e parimeve didaktike në fushën e të mësuarit të gjuhëve është një çështje tjetër shumë e rëndësishme, pasi orienton të gjithë aktorët që merren me fushën e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulave drejt prirjeve të reja dhe zgjidhjeve të përshtatshme për mësimin e gjuhës drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së të nxënësve. Por do të ishte e pamjaftueshme që të qëndronim vetëm në çështje që kanë të bëjnë me parime kritere dhe qëndrime të tjera që lidhen me vendimmarrjen apo hartimin e kornizave

Albana Tahiri, Esmeralda Strori

kurrikulare për fushën e komunikimit të gjuhëve, ndërkohë, të mos gjejmë shtratin ku këto parime, filozofi, kritere të vendosen në shtratin e tyre të zbatimit, të cilat lidhen me fusha të aplikimit siç janë metodat, strategjitë, teknikat dhe gjithçka që ka të bëjë me mësuesin dhe mësime-dhënien. Sipas profesoreshë Gjokutajt ‘‘Tërësia e komponentëve të mësime-dhënies dhe të nxënies të lëndës, teoritë e organizimit të procesit mësues në tërësi, metodat dhe format e organizimit të të mësuarit, të cilat vijnë nga fusha e mësime-dhënies dhe gjetjes së hapësirave funksionale për mësimin e gjuhës në shkollë dhe përtej saj janë aspekte didaktike të mësimit ‘’(1) Programi i gjuhës shqipe bazohet në parimin e integritetit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre, vit pas viti duke i zgjeruar dhe thelluar ato. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës, realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës. Në programe të kurrikulës së gjuhës shqipe arsimit parauniversitar synon që përmes mësimit të gjuhës shqipe por edhe përmes të gjitha lëndëve të tjera mësimore të: kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore, përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare të zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike, të zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit, të aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës; zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes; përdorin teknologjitë e reja (2).

Për realizimin e kompetencave të mësuesit përmes mësimit të gjuhës shqipe kërkohet që të përforcojnë njohuritë e tyre për gjuhën dhe komunikimin të krijojnë një marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe informacion; pasurojnë fjalorin e tyre, fitojnë njohuritë gjuhësore dhe gramatikore, si dhe zbatojnë rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar; shkruajnë qartë, saktë, në mënyrë koherente dhe përshtatin gjuhën dhe stilin e tyre në varësi të qëllimit, kontekstit dhe audiencës; përdorin diskutimin dhe ndërveprojnë me të tjerët me qëllim që të komunikojnë dhe mësojnë, si dhe shprehin qartë dhe argumentojnë mendimet dhe idetë e tyre, të zotërojnë artin e të folurit dhe të dëgjuarit, të bëjnë prezantime formale dhe marrin pjesë në diskutime dhe debate të ndryshme duke dhënë kontributin e tyre; përvetësojnë aftësitë e duhura për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekste për një larmi funksionesh; zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t’u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme; interpretojnë dhe vlerësojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi. Gjithashtu përmes kësaj fushe synohet dhe kërkohet të formohen dhe zhvillohen mendje që janë kritike të cilat gjykojnë, verifikojnë dhe nuk pranojnë çdo gjë që iu jepet (3).

(1) M. GJOKUTAJ, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, SHBLU, 2009, fq30.

(2) M. GJOKUTAJ. ‘‘Përvojë për mësimin e gjuhës amtare’’. -‘‘Kurrikula dhe shkolla’’, Gjuhëshqipe& leximletrar, Tiranë ISP2001. fq112-134.

ROLI I KURRIKULËS DHE I SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN GJUHËSOR TË FËMIJËVE

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës studiu-ueset shprehen se; ‘mësuesi ndjek këto hapa: përzgjedh rezultatin/et e të nxënësit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse; përcakton rezultatin e të nxënësit të kompetencave kyçe për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program); përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënësit; planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t’i arrijë rezultatet e të nxënësit brenda vitit shkollor; kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënësit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e gjuhës shqipe’⁽³⁾

Dallimi mbi kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe në kornizën kurrikulare synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së të nxënësit të shprehive të gjuhës: lexojmë, flasim shkruajmë. Këto kompetenca të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe të pasqyruara që në synimet e kësaj kornize kanë një pritshmëri të madhe në lidhje me cilësinë e të nxënësit.

Profesor Rrokaj shprehet se ; gjuha është një sistem që evoluon, gjithmonë është e lidhur me të shkruarën dhe të ardhmen. Gjuha shqipe është jo vetëm disiplinë, por edhe gjuhë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënësit. Si e tillë, lidhjet e saj me fushat dhe lëndët e tjera mësimore duhet të jenë të qarta dhe të ndërlidhura.’⁽³⁾

Një nxënës që nuk zotëron mirë kompetencat gjuhësore ka pak mundësi të ketë arritje në fushat/lëndët e tjera mësimore. Natyrisht në këtë lidhje ka marrëdhënie të ndërlikuara midis gjuhës, kuptimit dhe të nxënësit, të cilat nevojiten të trajtohen dhe standardizohen më gjerë nga fushat e psikologjisë .

Në mënyrë të veçantë lënda e gjuhës shqipe lidhet me lëndët e tjera të fushës ‘Gjuhët dhe komunikimi’. Kështu, letërsia i ofron gjuhës një model të përsosur të përdorimit të gjuhës, ndërsa studimi i gjuhëve të huaja i siguron transferimin e njohurive gjuhësore nga një lëndë në një tjetër, por edhe vlerësimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe.

Gjuha shqipe (aftësitë e të lexuarit) mbështet kuptimin e ushtrimeve dhe teksteve matematikore, nga ana tjetër aftësitë për të zgjidhur probleme në matematikë ndikojnë në gjykimin dhe mendimin kritik të nxënësve rreth teksteve të ndryshme.

Kuptimi ose analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi dhe kuptimi. Po kështu, p.sh., leximi i një teksti i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.

⁽³⁾ SH. RROKAJ. Çështje të gjuhës shqipe, Abatros, Tiranë, 2007 fq. 211

Lënda e gjuhës shqipe është e lidhur edhe me historinë dhe shkencat shoqërore, përderisa të gjitha tekstet që studiohen nga nxënësit kanë një kontekst historik dhe socio-kulturor.

Kështu analiza e teksteve të ndryshme me tematikë nga arti, i ndihmon nxënësit për lëndët e arteve, gjithashtu, studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme si p.sh., i reklamave kërkon integrim me artet për elementet pamore të reklamave marrëdhënie këto që nevojiten mes paralelizmit të fushave.

Lidhja e gjuhës shqipe me fushat dhe lëndët e tjera, është e nevojshme në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, për kultivimin e qëndrimeve qytetare e sociale.

Në lëndë e fusha të ndryshme me njëra- tjetrën, lidhen ngushtë parimet shkencore të përgjithshme didaktike. Parimet specifike që bëjnë të mundur ndryshimet dhe risitë në mësimdhënie padyshim nuk mungojnë edhe në fusha të tjera ku ne mundet ti studiojmë. Këtu na ndihmojnë fushat që lidhen me studimet e mendjes (psikologjia), studimet e trurit (neurologjia e biologjia) dhe studimet e kulturave (antropologjia). Gardner shprehet se ;“Në të vërtetë, ajo pjesë që ka ndryshuar në të shkuarën e afërt është të kuptuarit nga ana jonë e disa prej këtyre fushave. Tani ne jemi në gjendje të përfitojmë nga këto njohuri, si diçka e sigurt për të ndryshuar peizazhin edukativ dhe të arrijmë të kuptojmë të vërtetën, të bukurën dhe të mirën,por do të ishte e pafalshme të mos u kushtonim rëndësinë e duhur burimeve të informatikës, siç do të ishte faj i madh t’i kushtonim rëndësi vetëm njërës duke përjashtuar të tjerat.”⁽⁴⁻⁷⁾

Gjuha shqipe lidhet edhe me teknologjinë e cila i jep dhe më shumë hapësirë përdorimit dhe përmirësimit të shprehive gjuhësore të të lexuarit dhe të shkruarit. Futja e risive teknologjike në mësimdhënie është një sfidë e re për mësuesit e nxënësit, pikërisht duke zhvendosur mësimin nga kushtet e auditorit në ambientet e shtëpisë, kërkon, që mësuesi të punojë me përkushtim dhe profesionalizëm, ku është e nevojshme të ketë një qasje vazhdimësie në formimin e tij.

Shembujt e mësipërm janë vetëm një nxitje për të kuptuar se në procesin mësimor krijohen mundësi për integrim mes fushave të të nxënës. Ky integrim i lejon nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta,por të kemi parasysh: grupmoshën e fëmijëve së cilës po i drejtohem, veçoritë psikologjike dhe fizike të fëmijëve, mjedisin fizik të të nxënës .

1.1 Kompetenca gjuhësore ndërtimi dhe zhvillimi i tyre

Puna për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës nuk është e copëzuar dhe fragmentare. Çdo orë mësimore kontribuon për to.Po kështu, kompetencat ndërlidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, kompetenca e të lexuarit dhe të dëgjuarit të teksteve të ndryshme të gjuhës së folur, së shkruar dhe mediatike (njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e kësaj

⁽⁴⁾ H.GARDNER, ‘ *Multiple Intelligence:*’ New horicon N U: Basic Books, 2006 fq.52-53

kompetence) ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar dhe për të folur ose formimi i nxënësve për sistemin gjuhësor të shqipes (përdorimi i drejtë i gjuhës) ndikon në zhvillimin e kompetencave të tjera. Më poshtë janë dhënë përshkrimet e kompetencave të lëndës.

Kompetenca e të dëgjuarit dhe të folurit për të komunikuar dhe për të nxënë.

Të folurit është proces themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe biseduar, nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tyre. Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore dhe stilin që ata përdorin.

Nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Përmes situatave të të nxënësit aftësohen për të folurit në publik.

Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm, me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët: duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë përdorim e dikton situata dhe dëgjuesit; duke diskutuar në grupe dhe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në modelimin e diskutimeve dhe debateve, si dhe në përfshirjen dhe angazhimin e të tjerëve për të përmbushur afatet dhe qëllimet; duke respektuar gjatë prezantimeve me gojë karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.; duke përzgjedhur fjalët e frazat e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme; duke përdorur dhe vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj. Të lexuarit e teksteve të gjuhës së folur, së shkruar, mediatike (Në ndryshim nga arsimit bazë, në këtë cikël të dëgjuarit dhe të lexuarit janë përcaktuar si një kompetencë. Kjo për shkak se përgjatë gjithë viteve të arsimit 9-vjeçar është punuar nga mësuesit për të dëgjuarit dhe se në të dyja rastet (edhe kur dëgjon edhe kur lexon) nxënësi është në pozicionin e marrësit të mesazhit. Në të dyja rastet nxënësi, pothuajse demonstroi të njëjtat shkathtësi si p.sh., demonstroi të kuptuarit, interpreton, integron, gjykon, vlerëson etj).

Gjatë mësimit të kërkohet që nxënësit të dëgjojnë dhe të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues e dëgjues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm të kuptojnë njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe të jetë në gjendje t'i përdorë ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri tekstesh. Njohja me tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të plotësohen intelektualist në rrugën e dijeve. Të lexuarit për të nxënë është një kërkesë e kohës.

Albana Tahiri, Esmeralda Strori

1.2 Kompetenca e të shkruarit personal dhe funksional

Të shkruarit iu jep mundësi të fuqishme nxënësve për të mësuar për veten e tyre dhe për t'u lidhur me botën. Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit.

Nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Nxënësit zbatojnë gjatë të shkruarit karakteristikat e teksteve, si dhe rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.

Kompetenca e përdorimit drejtë të gjuhës. Nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen të përdorin saktë dhe brenda rregullave gramatikore gjuhën. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre. Nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatimin e rregullave drejtshkrimore dhe të pikësimit.

1.3 Çështje gjuhësore në kontekstin e zhvillimit të mendimit kritik dhe mësimdhënia.

Në kohët e sotme, vëmendja po fokusohet gjithnjë e më tepër në fushën e studimeve të integruara, të tilla si: psikolinguistikë, sociolinguistikë etj. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë po i kushtohet studimeve në fushën e gjuhësisë së zbatuar dhe në atë gjenerative. Sipas Çomskit, qëllimi kryesor i teorisë gjuhësore është të shpjegojë se si fëmijët arrijnë të përvetësojnë që në moshë të hershme gramatikën e të rriturve. Kërkime ndërgjuhësore mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit sintaksor kanë dhënë rezultate interesante dhe hedhin dritë mbi ndërveprimin e sintaksës me komponentë të tjerë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë⁽⁸⁻¹⁰⁾. Kështu, marrëdhënia midis përvetësimit të gjuhës dhe variacioneve sintaksore është shumë e rëndësishme.

Sipas Bloom (1956) Lidhja midis shkrimit dhe të menduarit kritik në kontekstin e shkollës është përpunuar nga studiues të ndryshëm sepse të menduarit kritik përfshin një gamë të gjerë aftësish si dhe nënaftësish

Psikologët Linda Elder dhe Richard Paul dhe njëkohësisht autoritet për mendimin kritik shprehin se; "Mendimi kritik është aftësia për të menduar qartë dhe në mënyrë racionale ku përfshihet aftësia për t'u përfshirë në mendime refleksive dhe të pavarura. Një person me mendim kritik është i aftë të kuptojë lidhjet logjike midis ideve, të identifikojë, të ndërtojë dhe vlerësojë në argumente, të zbulojë gabime të zakonshme dhe mungesë konsistence në arsyetim; të zgjidh probleme, të reflektojë mbi justifikimin e besimeve dhe vlerave të veta etj." (11-12)

ROLI I KURRIKULËS DHE I SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN GJUHËSOR TË FËMIJËVE

Nëse do t'i drejtoheshim teorive të zhvillimit të të menduarit, veçojmë se të menduarit në mënyrë kritike përmes strukturave të zgjeruara sintaksore, përfshin thithjen e ideve dhe shqyrtimin e ndikimit të tyre, paraqitjen e tyre në një mënyrë të stërholluar me baraspeshimin e tyre përballë pikëpamjeve të kundërta, ndërtimin e sistemeve të besueshme për t'i provuar ato dhe ndërmarrë në një qëndrim të bazuar në këto struktura⁽¹³⁻¹⁶⁾. Mësuesit duhet të sigurojnë një strukturë mësimdhënie për të menduarin dhe të nxënëit që të jetë, njëherazi sistematike dhe e dukshme. Vetëm kështu nxënësit do të njohin se ku janë në të menduarit e tyre me qëllim që të vëzhgojnë dhe drejtojnë proceset e të menduarit kur mësojnë në mënyrë të pavarur. Mësuesit nuk duhet të harrojnë se mendimi kritik është një proces i ndërlikuar i përfshirjes së ideve dhe burimeve në mënyrë krijuese, i rikonceptualizimit dhe ristrukturimit të koncepteve dhe informacionit.

“Të nxënëit duhet kuptuar si një veprimtari më shumë aktive se pasive. Gjenerimi i ideve pro dhe kundër çojnë në kërkime të mëtejshme përmes zgjerimit të fondit të pyetjeve që vijnë nga nxënësit duke shkuar drejt realizimit të vlerësimit të njohurive Nxënësit në këtë proces janë të aftë të vlerësojnë njëri tjetrin ,por edhe vetveten,janë më të vetëdijshëm në realizimin e procesit”(GJokutaj 2005)

1. Diskutime

Përmirësimi i kurrikulave bazuar në koherencë me programet e kësaj lënde, me vendet europiane dhe me ndryshimet që bëhen në këto programe si dhe risitë në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënëit ndikojnë në përmirësimin dhe në rritjen e përgjegjshmërisë së mësimdhënësve, të cilët, duhet të dalin nga korniza e tradicionales, duke krijuar kështu, mundësinë e praktikimit në mësimdhënie me në qendër nxënësin⁽¹⁷⁾. Të mësuarit me kompetenca është një trend i kohës, zbatimi i të cilave, kërkon strategji të gjetura dhe të suksesshme të nxëni. Arritja e kompetencave sipas fushave të të nxënëit duhet të shoqërohen me instrumente të sakta vlerësimi dhe kontrolli. Një strukturë e qartë e mësimdhënies do të përfshinte në zhvillimin e mendimit kritik nxënësit.

Kështu ata do të përfshiheshin me dëshirë në detyrat për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara do të njohin se ku janë në të menduarit e tyre me qëllim që të vëzhgojnë dhe drejtojnë proceset e të menduarit kur mësojnë në mënyrë të pavarur.

Zhvillimi i mendimit kritik duhet të jetë një proces i vazhdueshëm didaktik në të gjitha veprimtaritë e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit të nxënësve.

Pikërisht, auditorët e universiteteve kanë për detyrë të formojnë mësues që janë në gjendje të zbatojnë një kurrikul të re, që bazohet në kompetenca, dhe zbatojnë risi didaktike në mësimdhënie, ku nxënësi është në qendër të saj dhe mësimdhënia merr karakter gjithëpërfshirës.

Referencat

1. M. GJOKUTAJ, Didaktika e gjuhës shqipe, Tiranë, SHBLU, 2009, fq30.
2. M. GJOKUTAJ. “Përvojë për mësimin e gjuhës amtare”. -“Kurrikula dhe shkolla”, Gjuhëshqipe& leximletrar,Tiranë ISP2001. fq112-134.
3. SH. RROKAJ. Çështje të gjuhës shqipe, Abatros, Tiranë, 2007 fq. 211
4. H.GARDNER, “Multiple Intelligence:” New horicon N U: Basic Books, 2006 fq.52-53
5. IZHA, Plani Mësimor i Arsimit Bazë, Tiranë, 2012 ngawebsite:www.arsimi.gov.al.
6. IZHA, Programe të kurrikulës së gjuhës shqipe, Tiranë, 2011 ngawebsite:www.arsimi.gov.al.
7. K. SHEGANI(SATKA)Identitet përmes gjuhës. nga fëmijëria në adoleshencë ,Tiranë OMSCA 2015 fq60 ngawebsite:www.arsimi.gov.al.
8. IZHA, Programe të kurrikulës së gjuhës shqipe, Tiranë, 2019 nga website:www.arsimi.gov.al.
9. M. GJOKUTAJ, Didaktika e gjuhës shqipe, Tiranë, SHBLU,2009,fq30
- 10.M. GJOKUTAJ “Përvojë për mësimin e gjuhës amtare”. -“Kurrikula dhe shkolla”, Gjuhëshqipe& leximletrar,Tiranë ISP2001.fq 112-134.
11. JEAN PIAGET, ‘Mbi pedagogjinë’, Tiranë ISP, 2005, fq 6,7
12. A. JUBANI, I. HOTI, M GJOKUTAJ, ‘Mësimdhënia e gjuhës shqipe përmes veprimtarive krijuese e ndërvepruese’ Tiranë “Shkronjë pas shkronje”, 2013,fq 60,
13. SH. RROKAJ, Çështje të gjuhës shqipe, Abatros, Tiranë, 2007 f. 211
14. VIVIAN JAMES COOK, Second language learning and language teaching, London, 1991
15. RICHARD PAUL; LINDA ELDER How to Improve Student Learning: 30 Practical Ideas. (2014). ISBN 978-0944583555.
16. M. GJOKUTAJ “Didaktika e gjuhës shqipe”, cit, f.263